



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dostuzvat Prijmljenost / Prijatulo Received / Dostivety	11.10.2023	3	viti god vege
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shënjë / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDPMSTHEK	6511/2023		1/11



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1083/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1083/2023 të datës 14.08.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson

Avokat me adresë rruga

kundër Vendimit me Nr. 153/2023 të datës 31.07.2023 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1083/2023 e datës 14.08.2023 e parashtruar nga ankuesja lidhur me pretendimin ankimor për kompensim material.

II. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1083/2023 e datës 14.08.2023 e parashtruar nga ankuesja lidhur me pretendimin ankimor për transferimin e saj, ashtu që Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.153/2023 i datës 31.07.2023 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Akt Emërimi i datës 08.08.2023 me numër: AE.Nr.12/2023.

III. Detyrohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ankueses t'ia bëjë kompensimin e shumës në vlerë prej 7,257.23Euro/cent në mënyrë retroaktive, në emër të pagave të papaguara.

IV. Detyrohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Ekonomisë që ankueses t'ia bëjë kompensimin e shtesës transitorie në vlerë prej 392.36€uro/cent dhe diferencën në pagë për muajin Gusht 2023 ndërmjet shumës së realizuar prej 681.67 uro/cent dhe pagës bazë sipas ligjit të ri të pagave.

V. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën **III** të dispozitiv në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij.

VI. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën **IV** të dispozitiv në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij

VII. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED] më datë 14.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5638/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.1153/2023 të datës 31.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve procedurale dhe shkeljeve materiale me rastin e transferimit të ankueses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 28.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 31.08.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK/2023 të datës 26.09.2022 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1081/2023 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5638/2023 të datës 14.08.2023 të parashtruar nga ankuesja përmes avokatit me autorizim në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 1180 të datës 31.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; E-mailin e datës 09.10.2023 nga MPJD me shkresat e bashkëngjitura (kalkulimin e pagave të papaguara, listën e pagave dhe formularin për kompensim retroaktiv); E-mailin e datës 09.10.2023 nga ME me shkresat e bashkëngjitura (Akt emërimit e datës 08.08.2023 dhe listën e pagave për gusht-shtator 2023); Ankesën me numër të protokollit 4188/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me numër VK/2023 të datës 23.06.2023; Vendimin me

numër A.nr.727/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin më numër A.nr.1015/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin përmes emalit të datës 28.04.2023 të drejtuar Emalin e datës 20.04.2023 te drejtuar Emalin e datës 17.03.2023 të drejtuar emalin e datës 20.04.2023 te drejtuar Emalin e datës 17.03.2023 te drejtuar Shkresën e datës 11.05.2023 lidhur me monitorimin e transaksioneve te llogarisë dega kryesore ne Prishtinë; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 28.08.; Përgjigjen në naksë të datës 31.08.2023; Autorizimin me numër të protokollit 1081/2023 të datës 17.08.2023;Vendimin me numër VK/2023 të datës 26.09.2023 te Kryetarit të Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 26.05.2023 të drejtuar Vendimin me numër VK/2023 të datës 23.06.2023; Emalin e datës 27.06.2023 të drejtuar Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore te Ministrisë se Ekonomisë për vitin 2022; Procesverbalin e datës 11.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër A.nr.727/2023 të datës 11.07.2023; Vendimin e Këshillit 1015/2022; Vendimin e Këshillit A.nr.727/2023; E-mailin e datës 17.03.2023 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së për Këshillin; Raportin e veçantë të punës së Komisionit të Ristrukturimit i datës 17.03.2023 me shifër:426/2023; Konkursin e datës 19.04.2023; Ankesën me numër protokollit 7161/2022 e datës 16.11.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të parashtruar nga ankuesja; Autorizimin e datës 19.09.2022; Kontratën e Punës të datës 01.09.2003 për ankueses; Kontratën e Punës me Nr.3/2006 e datës 15.04.2006 për ankuesen; Kontratën e punës me Nr. 4/2007 e datës 01.04.2007 për ankuesen; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër të kontratës 206/2011 të datës 11.05.2011; Akt Emërimit e datës 06.02.2012 për ankuesen; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me Nr. 072/2012 i datës 16.09.2013 për ankuesen; Vendimin me Nr.Ref: 768/2018 të datës 10.09.2018; Vendimin me Nr.1402022 të datës 15.09.2022 të DMZP-së; Kërkesën për dhënie e një kopje të dosjes së ankueses e datës 21.09.2022; Kërkesën për dhënie e një kopje të përshkrimit të detyrave të punës Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm e datës 22.09.2022 nga ankuesja; Vendimin me Nr. 143/2022 të datës 10.11.2022 të DMZP-së; Raportin Specialisti i datës 04.02.2022, 27.01.2022; Raportin nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës i datës 03.02.2022; Raportin kthyes nga diagnostika i datës 12.11.2021; Raportin nga konsulta i datës 21.04.2021; Raportin Mjekësor i datës 07.12.2021; Raportin Specialisti i datës 21.07.2021; Certifikatën e datës 31.01.2008, 08.06.2007, 24.05.2022; Certifikatën e trajnimit maj 2022; Certifikatën e trajnimit e datës 25.09.2015; Certifikatën e datës 27.12.2016; Certifikatën dhjetor 2009; Certifikatën e datës 02.05.2008; Certifikatë e martesës me Nr. M 11354585 e datës 28.02.2022; Certifikatën e trajnimit e datës 03.06.2010; Certifikatë trajnimi për periudhën 16-21.10.2011; Certifikatë e datës 29.08.2003; Certifikatën e datës 24.11.2005; Certifikata me Nr.20/15 e datës 15.01.2002; Certifikatë e datës 18.02.2020; Formulari i Vlerësimit për Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për vitin 2020 i datës 30.01.2020; Kërkesën për përgjigje në ankese me numër protokollit 7400/2022 e datës 25.11.2022; Përgjigjen në ankese me numër protokollit 7588/2022 e datës 02.12.2022; Raportin e Veçantë të Komisionit të Ristrukturimit me numër protokollit 1620 i datës 01.11.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike; Përshkrimin e punë për pozitën udhëheqës i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në MPJD i datës 30.09.2022; Akt Emërimit me numër AE.Nr.61/2022 i datës 13.06.2022 për Vendimin me Nr. 18/2022 të datës 10.05.2022 të DMZP-së; Diplomën me Nr. 5221 për Diplomën me Nr. 71 për Licencë me numër 113/2018 e datës

15.02.2018 për Ndryshmin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me Nr. Port: 87 i datës 01.02.2018 për Akt Emërimit me Nr. Ref: 605/2014 i datës 06.05.20154 për Formularin e Vlerësimit për Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për vitin 2021 i datës 31.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 20.01.2021, 31.12.2019, 24.12.2018. 20.07.2017, 29.12.2016, 22.12.2015, 30.12.2014, 30.12.2013; Listën për pjesëmarrje në trajnimin në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional; Certifikatën për periudhën 06-10.11.2022 për Certifikatë e Avancuar Profesionale për Prokurim e vitit 2022; Certifikatën për trajnim tetor 2022; Certifikatën e datës 24.05.2022; Njoftim për programin e trajnimit të Avancuar profesionale për prokurim; Certifikatë e trajnimit e datës 13.08.2011; Emailin e datës 30.11.2021 nga Certifikatën e trajnimit gusht 2021; Certifikatën e trajnimit për periudhën 23-24.03.2021 për Certifikatë nme Nr. Port:112/2021 e datës 22.06.2021; Emailin e datë 04.12.200 nga Certifikatën për trajnim për periudhën 29-30.09.2020 për Emailin e datës 01.12.2020 nga Certifikatën e trajnimit për periudhën 15-16.10.2019; Certifikatën nga KAF e datës 16.12.2018; Certifikatë trajnimit për periudhën 11, 21 dhe 22.03.2019; Raport për pjesëmarrje në trajnim i datës 04.01.2019; Lista e kandidatëve që kanë kaluar testin/2018; Certifikatën trajnimit për periudhën 27-28.09.2018; Certifikatë trajnime për periudhën 02-03.05.2018; Certifikatën e trajnimit për periudhën 29-30.11.2018; Emailin e datës 18.09.2018 nga Certifikatën e datës 10.11.2017; Certifikatën e muajit qershor 2016; Licencën me Nr. VP-251 e datës 06.06.2017; Certifikatë trajnimit prill 2017; Certifikatë e datës 11.04.2017; Certifikatë për periudhën 26-29.01.2017; Certifikatën e trajnimit për përudhën 02-03.03.2016 për Certifikatën e datës 29.05.2016; Certifikatën Themelore Profesionale të Prokurimit 2015-2017; Certifikatë e datës 02.12.2013; Certifikatën e trajnimit për periudhën 27-28.02.2013; Certifikatën për trajnim për periudhën 26-27.03.2015; Certifikatën për periudhën 20, 21,20.04.2012; Formulari i Vlerësimit për Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm i datës 24.10.2018, 31.10.2017, 31.10.2016, 31.12.2011, 26.10.2012; Masën disiplinore Vërejtje me Nr. Ref: 177/20022 e datës 25.03.2022 për ankuesen; Licencë e datës 15.02.2017; Certifikatën e datës 10.08.2010 për ankuesen; Certifikatën për periudhën 02-05.12.2009 për ankuesen; Certifikatën e datës 21.11.2018 për ankuesen; Emailin e datës 23.11.2022 nga Emailin e datës 15.11.2022 nga B.I; Vendimin VK.nr.199/2022 i datës 27.12.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Kodin RPC0002401 të datës 28.03.2022 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Konkursin me Kodin RPC0002139 të datës 19.04.2022 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, si dhe Konkursin me Kodin RPC0000583 të datës 26.04.2021 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rural.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e *pabazuar*, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me ç'rast si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kritereve për pozita të

caktuara. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar Komisioni i Ristrukturimit), kurse, me Vendimin me shenjë VPD Nr.01/2022 të datës 16.03.2022 ka miratuar përshkrimin e detyrave të punës të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me tej nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas Aktit të Emërimit nr.072/2012 të datës 16.09.2013 ka qenë e emëruar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Auditimit të Brendshëm në ish Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila pozitë është paraparë edhe me Rregulloren Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo që për këtë pozitë kanë ndryshuar kriteret e vendit të punës respektivisht janë përcaktuar kritere shtesë lidhur me kualifikimet e posaçme formale, rrjedhimisht si kritere për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Certifikim për Auditim të Brendshëm për Sektorin Publik, Certifikim dhe menaxhim të përgjithshëm në fusha tjera të ngjashme, Edukim i Vazhdueshëm Profesional - minimum gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) vite të njëpasnjëshme sipas kërkesave të përcaktuara ligjore.*

Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit me numër protokoll 596 të datës 19.04.2022, ka konstatuar së ankuesja ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur me arsimin dhe përvojën e punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm mirëpo e njëjta nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale të miratuara nga DMZP-ja lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional-minimumi 60 orë trajnim brenda 2 vetëve të njëpasnjëshme sipas kërkesave të përcaktuara ligjore, andaj, meqenëse ankuesja nuk plotëson kriteret e posaçme për asnjë pozitë tjetër të lirë në MPJD, propozon që ankuesja të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, kurse sipas Raportit plotësues të datës 22.04.2022 propozon që ankuesja të transferohet në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Raportime Financiare në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me Vendimin Nr.140/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ankuesja është transferuar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Ankuesja më datë 22.08.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me mos sistemimin e ankueses, ndërsa Këshilli më vendimin me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, ka anuluar Vendimin Nr.140/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, më Raportin e Veçantë të Punës të datës 31.10.2022, ka konstatuar së ankuesja nuk mund të sistemohet përkatësisht të transferohet në ndonjë pozitë të lirë brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak së e njëjta nuk ka plotësuar kushtet e posaçme formale lidhur me njohjen e gjuhëve të huaja, duke

propozuar që ankuesja të transferohet në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 10.11.2022 ka nxjerr Vendimin me Nr.143/2022 përmes të cilit ankuesen e ka transferuar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Ankuesja më datë 16.11.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.143/2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme i datës 10.11.2022, ndërsa Këshilli më Vendimin me numër A.nr.1015/2022 të datës 18.01.2023, ka anuluar Vendimin Nr.143/2022 të datës 10.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.1015/2022 të datës 18.01.2023, më Raportin e Veçantë të Punës të datës 17.03.2023, ka konstatuar së ankuesja nuk mund të sistemohet përkatësisht të transferohet në ndonjë pozitë të lirë brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak së e njëjta nuk ka plotësuar kushtet e posaçme formale lidhur me njohjen e gjuhëve të huaja, duke propozuar që ankuesja të transferohet në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë. Ankuesja pavarësisht faktit së Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Raportin e Veçantë të Punës të datës 17.03.2023 kishte kërkuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që të njëjtën ta transferojë në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, DMZP nuk kishte marr veprime procedurale, ndërsa ankuesja me datë 11.05.2023 kishte parashtruar ankesë në Këshill për shkak të heshtjes administrative, kurse Këshilli me datë 11.07.2023 kishte nxjerrë Vendim A.nr.727/2023 përmes të cilit ishte detyruar Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që të nxjerrë akt administrativ lidhur me transferimin e ankueses.

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit A.nr.727/2023 të datës 11.07.2023 dhe duke u bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit sipas Raportit të Veçantë të Punës të datës 17.03.2023, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 31.07.2023 ka nxjerr Vendimin me Nr.153/2023 përmes të cilit ankuesen e ka transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi i kundërshtuar më ankesë është nxjerrë më shkelje procedurale dhe materiale, duke shtuar së procedura e transferimit të ankueses është bërë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ngase e njëjta e ka statusin e veçantë të nëpunësit civil si dhe posedon gradë diplomatike e cila në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë nuk mund të përdoret, sikurse Komisioni i Ristrukturimit me rastin e analizimit të dosjes së ankueses dhe kandidatit tjetër të përzgjedhur për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në MPJD nuk kanë vepruar drejtë pasi që kundër kandidati ka më pak

kualifikime, trajnime profesionale dhe përvojë pune me kërkesën që Këshilli të aprovojë si të bazuar ankesën e ankueses, të anulojë raportin e veçantë të punës së Komisionit të Ristrukturimit të datës 17.03.2023 dhe Vendimin me Nr.153/2023 të datës 31.07.2023 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme ndërsa ankueses t'ia njoh pagën dhe beneficionet që rrjedhin që nga data 15.09.2022 e deri në zbatimin e këtij vendimi sipas aktit të emërimit të datës 16.09.2013.

Lidhur me pretendimet e ankueses se me rastin e poentimit të kandidatit tjetër i cili është caktuar në pozitën **Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës** se Komisioni i Ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material me rastin e transferimit të nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit ngase nuk ka analizuar drejtë dosjen e ankueses pasi që e njëjta ka qenë më e kualifikuar, ka pasur përvojë më të madhe në shërbimin civil dhe ka ndjekur më shumë trajnime profesionale, Kolegji i Këshillit konstaton se një çështje e tillë pavarësisht që është konsumuar ngase është shqyrtuar edhe në vendimmarrjet paraprake, sërish thekson faktin se ky pretendim është i paqëndrueshëm, ngase kundër kandidati tjetër [redacted] i cili është nënshtruar formulës së njëjtë të poentimit sikurse ankuesja dhe se i njëjti ka arritur të grumbulloi gjithsejtë nëntëdhjetë e një pikë pesë (91.5) pikë apo për secilën fushë si vijon: (1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil-11.5 pikë, 2. Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë-30 pikë; 3. Kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë-30 pikë dhe 4. Trajnimet-20 pikë), ndërsa ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë shtatëdhjetë e një (71) pikë apo për secilën fushë si vijon: (1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil-19 pikë, 2. Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë-18 pikë; 3. Kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë-20 pikë dhe 4. Trajnimet -14 pikë), nga rrjedh se diferencën më të madhe prej 12 pikëve të vlerësimit ankuesja e ka në fushën vlerësimet e rezultateve në punë, dhe se për këtë çështje ankuesja nuk ka mund të argumentojë me prova të kundërtën e saj, ndërsa sa përket kriterit të poentimit lidhur me vjetërsinë në punë, vërehet qartë se ankuesja është vlerësuar më shumë sesa kundër kandidati nga rrjedh se pretendimi i saj është i pabazuar, sikurse lidhur me kualifikimet profesionale ku nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja posedon Diplomën Çertifikatën e datës 15.01.2002 përmes të cilës dëshmohet se me datë 06.12.2001 ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik-Universiteti i Prishtinës gjegjësisht e njëjta me datë 06.12.2001 ka mbrojtur temën e diplomës "Plehrat, nitrati i amonit gëlqeror" dhe ka marr titullin Ekonomist i Diplomuar në Universitetin e Prishtinës, ndërsa kundër kandidati [redacted] posedon diplomën e datës 15.06.2015 me numër :5221 përmes të cilës dëshmohet se me datë 17.03.2008 ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik-Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe ka marr titulli: Bachelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet me gjithsejtë 180 kredi/ETC, po ashtu i njëjti posedon diplomën e datës 19.06.2017 me numër :71 përmes të cilës dëshmohet se me datë 08.06.2017 ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik-Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe ka marr titullin: Master për Banka, Financa dhe Kontabilitete me gjithsejtë 120 kredi/ETC nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankueses se e njëjta është më e kualifikuar sesa kundër kandidati [redacted] është i pabazuar ngase e njëjta këtë pretendim nuk e mbështet me ndonjë dokument tjetër të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë/universitar përveç çertifikatës të datës 15.01.2022, përderisa kundër kandidati [redacted] ka dy (2) diploma me gjithsejtë 300kredi/ETC dhe gradë më të lartë të kualifikimit/Master, prandaj ngase u tha më lartë pretendimi i ankueses është i pabazuar ndërsa Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 14 paragraf 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve

Civil sikurse përcaktohet: "Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e hartimit të raportit të veçantë me numër protokoli:246 të datës 17.03.2023 përmes të cilit e ka rekomanduar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ta transferojë ankuesen në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, ka gjetur se ka bërë përshkrimin e të gjitha pozitave të lira prej tyre trembëdhjetë (13) pozita të Udhëheqësve të Divizioneve dhe për gjitha prej tyre kërkohen edhe kushte të veçanta formale, gjegjësisht për të njëjtat varësisht prej funksionit dhe detyrave që hyjnë në mandatin e tyre kërkohen njohje e gjuhëve të huaja, sikurse gjuha angleze, frënge, apo gjermane dhe atë duke filluar nga niveli C1-C1 e deri tek B2-C2 të dëshmuara me Çertifikatë nga ndonjë institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura, ndërsa sipas shkrësive të lëndës respektivisht të dosjes së ankueses të dërguara nga institucioni punëdhënës dhe provave të sjella nga ankuesja, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja nuk ofron një dëshmi të tillë se e njëjta njeh ndonjërin nga gjuhët e huaja të kërkuara për pozitën në fjalë, gjegjësisht nuk ka ndonjë Çertifikatë të lëshuar nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar dhe e njëjta nuk mund të transferohet në asnjërin nga këto pozita që kanë qenë të lira, pasi që edhe dispozitat ligjore lidhur me transferimin për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit përcaktojnë kërkesat e veçanta formale sikurse në nenin 54 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit".

Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankueses të datës 16.11.2022 të cilën e kishte kthyer në ri-shqyrtim përmes vendimit A.nr.1015/2022 të datës 18.01.2023, ka pasur parasysh statutin e nëpunësit të shërbimit të jashtëm dhe ka dashur t'i ofrojë një mundësi ankueses pasi që e njëjta insiston të mbetet pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në frymën e nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, mirëpo e njëjta duhet ta ketë parasysh faktin se dispozitat e ligjit të veçantë për shërbimin e jashtëm diplomatik nuk e përcaktojnë dhe as nuk e rregullojnë çështjen e transferimit të nëpunësit civil me rastin e ristrukturimit të institucionit sikurse në rastin konkret, prandaj mbi këtë bazë vlejné dispozitat e nenit 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil" dhe se transferimi i ankueses në

rastin konkret është bërë në pajtueshmëri me më normën e lartcekur, ndërsa ankuesja duhet ta ketë parasysh faktin e përcaktuar sipas nenit 15 paragrafi 4 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: *"Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përveç atyre të përcaktuara me Neni 52. paragrafin 3 të Ligjit përbën shkak për lirin nga shërbimi civil"* dhe se e njëjta nuk mund ta refuzojë transferin pasi që në rrethanat e rastit konkret nuk plotësohen këto parakushte që ndërlidhen me nenin 52 paragrafit 3 të ligjit material sikurse janë gjendja shëndetësore, dhe distanca ndërmjet vendbanimit të nëpunësit civil me vendin ku transferohet.

Nga të cekurat si më lartë është konstatuar se pozita e ankuseses që ka mbajtur brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka pasur ndryshime në kriteret e vendit të punës respektivisht janë përcaktuar kriteret shtesë lidhur me kualifikimet e posaçme formale, atëherë në këtë rast Kolegji i Këshillit ju referua nenit 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës"*, ndërsa, pas ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Komisioni i Ristrukturimit ka bërë përpjekjet ligjore që ankuesen të sistemoj brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, por meqë e njëjta nuk ka arritur të grumbulloi pikë më shumë sesa kandidati tjetër për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa për pozitën e tjera të lira të kategorisë së njëjtë nuk ka plotësuar kriteret e veçanta formale, atëherë mundësia e vetme ka qenë propozimi për transferim në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, ashtu siç parashihet edhe me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil"*, prandaj Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e përgatitjes së Raportit të veçantë me numër: 426 të datës 17.03.2023 me propozimin për transferimin e ankuseses pas shterjes së mundësive duke respektuar pikëpamjet juridike të vendimit të Këshillit me numër A.nr.1015/2022 të datës 18.01.2023 dhe Vendimit me numër A.nr.727/2023 të datës 11.07.2023, sikurse edhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.153/2023 të datës 31.07.2023 për transferimin e ankuseses në një pozitë të ngjashme edhe për nga kategoria funksionale dhe përshkrimi i detyrave të punës, pra në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, kanë vepruar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe kanë zbatuar drejtë dispozitat e ligjit material, gjegjësisht ankueses i është ruajtur vazhdimësia në detyrë sipas pozitës dhe kategorisë së njëjtë.

Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit*

administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë” në mbështetje edhe të nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ndërlidhur me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstatoi se transferimi i ankueses me rastin e ristrukturimit të institucionit është zbatuar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, prandaj mbi këtë bazë Vendimi Nr.153/2023 i datës 31.07.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si dhe akti i emërimit i datës 08.08.2023, mbeten në fuqi pasi që ankuesja i plotëson kriteret e parapara për pozitën në të cilën është transferuar ndërsa ankesa e ankueses e datës 14.08.2023 lidhur me pretendimin ankimor për transferimin e saj është e pabazuar.

Lidhur me kërkesën për kompensim material, Këshilli me datë 09.10.2023 ka pranuar prova shtesë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD-së dhe ka konstatuar se ankuesja ka pasur pagën në vlerë prej 1,395.62Euro/cent dhe për muajin Shtator të vitit 2022 ka marr pagë në vlerë prej 697.81Euro/cent apo gjysmën e pagës, pra ka realizuar 697.81Euro/cent më pak sesa që është dashur të paguhet për muajin shtator, kurse për muajin Tetor e njëjta ka realizuar vetëm 139.56Euro/cent apo 1,256.06Euro/cent më pak se sa që është dashur të paguhet për muajin Tetor, ndërsa për muajt Nëntor e Dhjetor të vitit 2022 dhe muajt, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik të vitit 2023 nuk është paguar fare. Po ashtu nga shkresat e lëndës Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ia kanë njohur të drejtën në kompensim për periudhën nga muaji shtator i vitit 2022 deri në korrik 2023 në vlerën e përgjithshme prej 14,514.45€ ku prej të cilave sipas formularit të pagesës retroaktive me shifër TH/SP/F04 i datës 08.09.2023 i janë pagur gjysma e shumës së njohur apo 7,257.23Euro/cent, ndërsa gjysma e mbetur apo 7,257.23Euro/cent do t'i paguhet në muajin tetor të vitit 2023, mirëpo deri në momentin e dorëzimit të shkresave në fjalë ankuesja vlerën e mbetur prej 7,257.23Euro/cent nuk e ka realizuar pavarësisht zotimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, prandaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor për këtë çështje aprovohet pjesërisht, ashtu që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës obligohet që ankueses t'ia paguajë pjesën e mbetur prej 7,257.23Euro/cent në emër të pagave të papaguara.

Mirëpo, Këshilli me qëllim të eliminimit të paqartësive eventuale lidhur me të drejtën në kompensim me shkresë i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë, ndërsa të njëjtit kanë pohuar se ankueses i është lëshuar Akt i Emërimit me datë 08.08.2023 dhe e njëjta ka filluar të punoi në Ministrinë e Ekonomisë në pozitën **Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm**, ndërsa sipas listës së pagave e njëjta për muajin gusht 2023 është paguar në vlerën prej 681.67Euro/cent, ndërsa për muajin shtator e njëjta është paguar në shumën prej 1,215.47 Euro/cent duke përfshirë në këtë shumë edhe kompensimin në emër shtesës transitore në vlerën prej 392.36Euro/cent në muaj, nga rrjedh se sipas shkresave të lëndës ankuesja për muajin gusht 2023 nuk është paguar me pagë të plotë ngase të njëjtës pagën ia kanë lidhur me datën e lëshimit të aktit të emërimit 08.08.2023, sikurse e njëjta nuk e ka marr kompensimin në emër shtesës transitore në vlerën prej 392.36Euro/cent për muajin gusht, prandaj e njëjta në këtë rast është dëmtuar, ngase Vendimi me Nr.153/2023 i datës 31.07.2023 përmes të cilit e njëjta është transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit duke e detyruar

Njësinë përkatëse që t'ia lëshoj aktin e emërimit, nga rrjedh se ankuesja nuk është dashur të dëmtohet në pagë në vlerën e diferencës së përkthyer prej 7 ditëve kalendarike të muajit gusht 2023, sikurse edhe kompensimin e shtesës transitore në vlerë prej 392.36€uro/cent, prandaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është pjesërisht i bazuar dhe lidhet vetëm me çështjen e kompensimit të pagave të përealizuara, prandaj pavarësisht zotimit dhe evidentimit edhe në e-mailin e datës 09.10.2023 nga Menaxherja e Personelit të Ministrisë së Ekonomisë se pagesa e së njëjtës lidhur me shtesën transitore do t'i kompensohet, Kolegji i Këshillit lidhur me këtë pjesë ka vendosur t'ia aprovojë ankesën duke e detyruar Ministrinë e Ekonomisë që ankueses t'ia bëjë kompensimin në vlerën prej 392.36€uro/cent në emër të shtesës transitore për muajin gusht 2023 si dhe diferencën në pagë për muajin gusht 2023 ndërmjet shumës së realizuar prej 681.67 uro/cent dhe pagës bazë sipas ligjit të ri të pagave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.1081/2023**

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses, Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë;
- Arkivot të KPMSHCK-së